

Ekran helmetë

Udhëzuesi i referencave

Përpara përdorimit të parë

Referojuni "Udhëzuesi i fillimit" për udhëzime mbi lidhjen e sistemit, vënien e njësisë dhe kryerjen e cilësimeve fillestare.

Paralajmërim

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo aparaturë nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështirës.

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit, mos mbuloni hapësirën e ajrimit të pajisjes me gazeta, mbulesa tavoline, perde, etj.

Mos e ekspozoni pajisjen ndaj burimeve me flakë të pambrojtur (për shembull, qirinjtë e ndezur).

Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo pajisje nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve me ujë dhe mbi pajisje nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëng, siç janë vazot.

Instaloheni këtë sistem në mënyrë që kordoni i rrymës (rrjetit elektrik) të mund të shkëputet nga priza e murit (rrjeti elektrik) menjëherë në rast problemi.

Mos e instaloni këtë pajisje në një hapësirë të kufizuar, si në një raft librash ose në një njësi të ngjashme.

Masat paraprake

Seti nuk shkëputet nga burimi i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) për sa kohë që është e lidhur me prizën e murit (rrjetin elektrik), edhe nëse seti vetë është i fiksuar.

Deklarata e mëposhtme FCC aplikohet vetëm për versionin e këtij modeli të prodhuar për shitje në SH.B.A. Versionet e tjera mund të mos jenë konform rregulloreve teknike FCC.

SHËNIM:

Kjo pajisje është testuar dhe është gjendur konform limiteve për pajisjet dixhitale të Klasit B, në përputhje me pjesën 15 të Rregulloreve FCC. Këto limite janë përcaktuar për të ofruar mbrojtje të arsyeshme kundër ndërhyrjeve të dëmshme në një instalim në shtëpi.

Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të përhapë energji të frekuencave radio dhe mund të shkaktojë interferenca të dëmshme me komunikimet radio nëse nuk instalohet dhe përdoret në përputhje me udhëzimet.

Megjithatë, nuk garantohej që nuk do të ndodhë interferencë në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme në marrjen radiofonike ose televizive, që mund të përcaktohet duke ndezur dhe fikur pajisjen, përdoruesi inkurajohet të përpilojë të korrigjojë interferencën përmes një ose më shumë prej masave të mëposhtme:

- Të riorientohet ose zhvendoset antena marrëse.
- Të rritet hapësira ndarëse mes pajisjes dhe marrësit.

- Të lidhet pajisja në një prizë në një qark të ndryshëm nga ai ku është lidhur marrësi.
- Konsultohuni me shitësin ose një teknik televizori/radioje me përvojë për asistencë.

Nëse keni pyetje mbi këtë produkt, ju mund të telefononi: Qendrën e Informimit të Klientëve Sony 1-800-222-SONY (7669) ose vizitoni <http://www.sony.com/>. Numri i mëposhtëm është vetëm për çështjet e lidhura me FCC.

Informacioni rregullator

Deklarata e konformitetit	
Emri tregtar:	SONY
Numri i modelit:	HMZ-T2
Pala përgjegjëse:	Sony Electronics Inc.
Adresa:	16530 Via Esprillo, San Diego, CA 92127 SH.B.A.
Numri i telefonit:	858-942-2230
Kjo pajisje është në përputhje me Pjesën 15 të Rregulloreve FCC. Përdorimi u nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme: (1) Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferenca të dëmshme, dhe (2) kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferenca që mund të shkaktojnë veprim të padëshiruar.	

Kini kujdes që ndryshimet apo modifikimet që nuk janë të miratuara shprehimisht në këtë manual të mos zhvlerësojnë të drejtën tuaj për të përdorur këtë pajisje.

Njoftim për klientët: informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm për pajisjet e shitura në vendet ku aplikohen direktivat e BE-së.

Ky produkt është prodhuar nga ose për llogari të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë e produktit bazuar në legjislacionin e Bashkimit Evropian, duhet t'i drejtohen përfaqësuesit të autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, ju lutemi referojuni adresave të dhëna në dokumentet e veçanta të shërbimit ose garancisë.

Kjo pajisje është testuar dhe është gjendur konform limiteve të përcaktuara në Direktivën EMC për përdorimin e një kabloje lidhëse më të shkurtër se 3 metra.



**Hedhja e pajisjeve të vjetra
elektrike dhe elektronike
(e aplikueshme në Bashkimin
Evropian dhe shtetet e tjera
evropiane me sistem të
diferencuar grumbullimi)**

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatese të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Masat paraprake shëndetësore

Kufizimet e moshës

Shikimi i imazheve video ose luajtja e lojërave nga kjo pajisje mund të ndikojë në shëndetin e fëmijëve në fazë rritjeje. Kjo pajisje nuk duhet të përdoret nga fëmijët 15 vjeç e poshtë. Përdorni veçorinë e mbrojtjes me fjalëkalim (faqe 25) të kësaj pajisjeje për të ndaluar përdorimin e kësaj pajisjeje nga fëmijët.

Shikimi i videos me ekranin helmetë

- Disa persona mund të vuajnë nga shqetësime (si p.sh. lodhje sysh, dobësi, të vjella ose marrje mendsh) gjatë shikimit të imazheve video ose gjatë luajtjes së lojërave. Sony rekomandon që të gjithë shikuesit të bëjnë pushime të rregullta kur shikojnë imazhe video ose luajnë lojëra. Kohëzgjatja dhe frekuenca e pushimeve të nevojshme do të variojë nga personi në person. Duhet të vendosni vetë si është më mirë. Nëse ju shkaktohen shqetësime, duhet të ndërprisni shikimin e imazheve video ose luajtjen e lojërave derisa të mos keni më shqetësime; nëse mendoni se është e nevojshme konsultohuni me mjekun.
- Shmangni vënien e njësisë në ambiente ku koka mund të tundet, ose gjatë kohës që jeni duke ecur ose duke kryer ushtrime, sepse ka më shumë mundësi që të vuani nga shqetësime.
- Duhet të shihni edhe (i) manualin e përdorimit të ndonjë pajisjeje ose mjeti tjetër që përdoret me këtë pajisje, si dhe (ii) faqen tonë të internetit më poshtë për informacionin më të fundit.

Për klientët në Evropë, Rusi, Ukrainë dhe Mbretërinë e Bashkuar:

<http://support.sony-europe.com/>

Për klientët në SH.B.A. dhe Amerikën Latine

<http://esupport.sony.com/>

Për klientët në Kanada:

<http://esupport.sony.com/CA/>

Për klientët në Kinë:

<http://service.sony.com.cn/index.htm>

Për klientët në vende/rajone të tjera:

<http://www.sony-asia.com/support/>

Përdorimi i saktë

- Sigurohuni që ta keni vendosur saktë njësinë helmetë.
 - Referojuni "Udhëzuesit të fillimit" për udhëzime mbi vënien e njësisë.
 - Për të shmangur shikimin me ekrane josimetrike, kontrolloni drejtvendosjen e ekraneve duke iu referuar ekranit të konfirmimit të shfaqur në fillim.
 - Vini re se rrëzimi i njësisë ose trajtimi i keq i saj mund të shkaktojë asimetri te ekranet.
- Njësia helmetë mund të përshtatet në një gamë prej 55 mm – 72 mm (2 1/4 inç – 2 7/8 inç) për t'iu përshtatur distancës mes syve (distanca mes bebeve të syve). Nëse nuk arrini ta përdorni sistemin brenda kësaj game, mos e përdorni sistemin.
- Pas tre orësh shikimi të vazhdueshëm me parazgjedhje do të shfaqet një mesazh paralajmërimi për fikje automatike. Nëse e largoni mesazhin dhe vazhdoni shikimin, sistemi do të fiket automatikisht pas 3 orësh të tjera.

Për shikim komod

Imazhet perceptohen sikur shfaqen në një farë distance nga shikuesi.

Nëse mbani normalisht syze ose lente kontakti, mbajini ato si zakonisht (me përjashtim të syzeve të leximit). Vini re se shikimi me syze bifokale mund të mos jetë optimal.

Masat paraprake

Furnizimi me energji

Pozicionojeni sistemin pranë prizës së murit (rrjetit elektrik) të përdorur. Në rast zhurmash të çuditshme, avujsh ose tymi nga sistemi, shkëputeni menjëherë kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) për ta fikur plotësisht rrymën. Vetëm shtypja e butonit të rrymës në njësinë helmetë nuk do ta fikë sistemin plotësisht.

Mjedisi i instalimit

Shmangni instalimin në mjediset e mëposhtme.

- Vendet ku mund të ketë dridhje
- Nën dritën e drejtpërdrejtë të diellit, ose aty ku është shumë nxehtë ose shumë lagështirë
- Vendet që janë jashtëzakonisht të ftohta

Gjithashtu, shmangni vendosjen e enëve të mbushura me lëngje (si p.sh. vazot me lule) mbi njësinë e përpunimit, ose ta përdorni sistemin aty ku mund të bien spërkatje. Sistemi mund të dëmtohet nëse spërkatet me ujë.

Kondensimi

Kondensimi ndodh kur lagështira e ajrit kondensohet mbi panelet metalike ose pjesë të tjera, duke formuar pikla uji. Kondensimi mund të formohet në sipërfaqet e jashtme ose të brendshme nëse sistemi papritur zhvendoset nga një mjedis i ftohtë në një mjedis të nxehtë, ose kur ndizet një ngrohës në një dhomë të ftohtë ku është instaluar sistemi. Nëse formohet kondensim, mos e përdorni sistemin derisa të avullojnë piklat.

- Nëse sistemi nuk është futur në një prizë muri (rrjetin elektrik).
Lëreni sistemin të shkëputur dhe prisni derisa të avullojnë piklat.
- Nëse sistemi nuk është i ndezur
Lëreni sistemin të fikur dhe prisni derisa të avullojnë piklat.
- Nëse sistemi është i ndezur
Lëreni sistemin të ndezur dhe prisni derisa të avullojnë piklat.

Përdorimi i sistemit kur është formuar kondensim mund ta dëmtojë atë.

Kujdesi për lentet

- Trajtojini lentet në njësinë helmetë me kujdes për të shmangur ndotjet ose gërvishjet. Nëse lentet ndoten, fshijini ato butë me një copë të butë për pastrimin e lenteve.
- Mos përdorni solucione lëngje, si p.sh. lëngje pastruese për lente, ujë apo pastrues me bazë alkooli.

Pastrimi i sistemit

Pastroni sipërfaqet e jashtme të sistemit duke përdorur një pëlhurë të butë të njomur paksa me një solucion larës të butë. Mos përdorni tretës si hollues, benzinë ose alkool të cilat mund të dëmtojnë sipërfaqet.

Kujdesi për kufjet

- Një fishë kufjesh e ndotur mund të shkaktojë ndërprerje ose kapërcim. Për të siguruar tingull optimal, pastrojeni fishën herë pas here me një pëlhurë të butë.
- Pastroni gjithashtu edhe aurikularët. Hiqini aurikularët nga kufjet dhe lajini ato me dorë duke përdorur një solucion larës të butë. Pas larjes, thajini aurikularët plotësisht përpara përdorimit.

Dëgjimi për një kohë të gjatë me volum të lartë

Dëgjimi me volum të lartë për periudha të gjata mund të dëmtojë dëgjimin. Për të mbrojtur dëgjimin, shmangni dëgjimin me volum të tepruar.

Volumi fillestar

Për të shmangur daljen e papritur me volum të lartë, mbajeni volumin fillestar të ulët. Ngrijeni volumin gradualisht derisa të arrini në nivelin e dëshiruar.

Materialet e ambalazhimit


Mbajeni kutinë origjinale dhe mbështjelljen mbrojtëse për përdorim në të ardhmen, në rast se transferoheni ose ju nevojitet të dërgoni me postë sistemin për riparime ose arsye të tjera.

Foletë dhe konektorët HDMI

Merrni këto masa paraprake për të shmangur dëmtimin e foleve dhe konektorëve HDMI.


- Kur futni kabllo, vini re formën dhe orientimin e konektorit dhe folesë HDMI në pjesën e pasme të njësisë së përpunimit.

Hyrjet dhe daljet HDMI



Konektori është me kokë poshtë

Hyrjet dhe daljet HDMI



Konektori nuk është drejt

- Përpara se të hiqni njësinë e përpunimit, gjithmonë shkëputeni kabllo HDMI.



- Mbajeni drejt konektorin kur lidhni ose shkëputni kabllo HDMI. Konektorin mos e mbani në kënd dhe as mos e fusni me forcë në follenë HDMI.
- Përdorni ose kabllo dhe dhënë HDMI ose një kablo HDMI të shpejtësisë së lartë që mund të blihet në dyqan.

Trajtimi i kordonit të njësisë helmetë

Merrni këto masa paraprake për të shmangur dëmtimin e folesë ose kordonit HMD OUT.

- Kur futni kordonin e lidhjes, vini re formën dhe orientimin e konektorit dhe folesë HMD OUT në pjesën e përparme të njësisë së përpunimit.
- Përpara se të hiqni njësinë e përpunimit, gjithmonë shkëputeni kordonin e lidhjes.
- Mbajeni drejt konektorin kur lidhni ose shkëputni kordonin e lidhjes. Konektorin mos e mbani në kënd dhe as mos e fusni me forcë në follenë HMD OUT.

Trajtimi i kufjeve

- Nëse keni reagim alergjik ndaj kufjeve të dhëna, ndaloni menjëherë përdorimin e tyre dhe kontaktoni me një doktor.
- Kur hiqni fishën e kufjeve nga njësia helmetë, sigurohuni që ta mbani me dorë fishën e kufjeve për ta hequr. Tërheqja nga vetë kordoni i kufjeve mund ta dëmtojë atë.
- Aurikularët mund të përkeqësohen pas një përdorimi ose magazinimi të zgjatur.

Përmbajtja

Masat paraprake shëndetësore	3
Masat paraprake	4
Veçoritë kryesore të produktit	8
Aksesorët e dhënë.	8
Pjesët dhe kontrollet.	10
Përshtatja e njësishë helmetë.	12
Konfirmimi i drejtvendosjes së ekraneve	16
System Settings	18
Zgjidhja e problemeve	28
Specifikimet.	35
Njoftim i licencës dhe markës tregtare	36

Veçoritë kryesore të produktit

Duke vënë në kokë ekranin helmetë, ju mund të shihni filma 3D dhe të luani lojëra 3D nga luajtësi i lidhur Blu-ray Disc™ dhe aparatet e lojërave.


Veçoritë kryesore të produktit janë si më poshtë.

- Shijoni video me një përvojë mbresëlënëse që simulon ekranin e madh të kinemasë përmes një këndi pamjeje horizontale të gjerë 45°.
- Shikoni video me kontrast të lartë dhe me definicion të lartë të prodhuar nga panele Sony HD OLED (LED organik) në njësinë helmetë.
- Lidhni sistemin me një pajisje të përputhshme me 3D për një përvojë realiste shikimi 3D. Shfaqja e njëhershme në të dy ekranet OLED eliminon imazhet e dyfishta që zakonisht ndodh te sistemet e vjetra me imazhe të alternueshme.
- Dëgjoni tingull rrethues virtual të thellë tërheqës me shumë kanale, të prodhuar nga kufjet dhe teknologjia Virtualphones Technology (VPT).
- Shijoni lojë më tërheqëse me lokalizimin e saktë të tingullit duke dëgjuar në modalitetin e lojës, i cili prodhon një tingull të projektuar posaçërisht për lojërat me efekte rrethuese me shumë kanale. Projektimi i tingullit të modalitetit të lojës për këtë sistem është kontrolluar nga projektuesit e tingullit pranë Sony Computer Entertainment.


Aksesorët e dhënë

Sigurohuni që artikujt e mëposhtëm të jenë të përfshirë me sistemin pas blerjes. Nëse mungon ndonjë artikull, kontaktoni shitësin Sony ose një qendër lokale të autorizuar Sony.


- Kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) (2 për Mbretërinë e Bashkuar, Hong-Kongun, Lindjen e Mesme, dhe modelet e Oqeanisë, 1 për modelet e tjera) Përdorëni kordonin e dhënë të rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) vetëm me këtë sistem, jo me pajisjet e tjera elektronike.
- Kabllloja HDMI (1)



- Bllokuesi i dritës (lart) (1 secila majtas dhe djathtas)




- Bllokuesi i dritës (poshtë) (1)




- Mbajtësja e kordonit të lidhjes (1)



- Mbulesa e mbështetëses së ballit (1)




- Kufjet (1)




- Aurikularët (masa S, L) (1 palë për secilën masë)
Aurikularët mesatarë kanë qenë të lidhur që në fillim në kohën e blerjes.
- Udhëzuesi i referencave (ky udhëzues)
- Udhëzuesi i fillimit

Pjesët dhe kontrollet

Njësia helmetë




* Butoni MENU shërben për dy qëllime. Shtypni butonin MENU për të parë menytë e cilësimit si edhe për të konfiguruar ndryshimet e cilësimit (kur funksionon si buton Enter).




* Mund të lidhen ose kufjet e dhëna ose kufjet tuaja stereo me mini-fishë.

Njësia e përpunimit (përpara)



Njësia e përpunimit (prapa)




Shënim

- Sinjalet burimore nuk mund të kalojnë përmes folesë HDMI OUT derisa të aktivizohet pasazhi HDMI (faqe 25) dhe sistemi helmetë të jetë fikur.


Përshtatja e njësisë helmetë

Njësia helmetë mund të rregullohet në një numër mënyrash për të siguruar një përshtatje të personalizuar dhe komode. Për një përshtatje më komode, gjithmonë rregullojeni njësinë helmetë përpara se ta vendosni.




① Rregullimi i mbështetjes së ballit

Mbështetësja e ballit mund të rregullohet përpara dhe prapa në katër pozicione të mundshme për të ndryshuar pikën e kontaktit me ballin. Rregulloni mbështetësen e ballit për një përshtatje të mirë duke pasur parasysh fokusin e qartë të imazhit, të mos kontaktojë me hundën, të ketë hapësirë të mjaftueshme mes syzeve dhe njësisë, e kështu me radhë.




Për të lëvizur prapa mbështetësen e ballit, thjesht tërhiqeni mbështetësen prapa.



Për të lëvizur mbështetësen përpara, duke e mbajtur levën e bllokimit të mbështetjes së ballit majtas, shtyjeni mbështetësen përpara, duke e mbajtur mbështetësen të ngritur.

Vendoseni mbulesën e mbështetjes së ballit sipas dëshirës.




Vendoseni mbulesën e përfshirë të mbështetjes së ballit.

Shënim

- Sigurohuni që mbështetësja e ballit të qëndrojë mirë, në mënyrë që të qëndrojë në kontakt me ballin gjatë shikimit. Nëse njësia dikton se mbështetësja e ballit nuk është vendosur në ballë gjatë shikimit, ekranet do të fiken automatikisht.


② Bllokuesi i dritës

Nëse drita e jashtme që reflektohet në ekrane tërheq vëmendjen, vendosni bllokueset e dritës.



Bllokuesi i dritës (lart)

Bllokuesi i dritës lart majtas etiketohet "L", ndërsa ai lart djathtas "R". Vendosni bllokuesin e duhur të sipërm në secilën anë dhe shtyni skadat brenda dy vrimave në krye të seksionit të lenteve.



Bllokuesi i dritës (poshtë)


Vendosni bllokuesin e poshtëm të dritës duke shtyrë skadat brenda katër vrimave në pjesën e poshtme të seksionit të lenteve dhe dy vrimave anash përpara se ta vendosni njësinë.

Shënime

- Mund të mos jetë e mundur të vendosen bllokuesit e dritës kur mbani disa lloje syzesh.
- Nëse drita e jashtme vazhdon të tërheqë vëmendjen pas vendosjes së bllokuesve të dritës, ulni dritat e dhomës ose largohuni nga drita e jashtme.


③ Vendosja e mbajtëses së kordonit të lidhjes

Në mënyrë që kordoni i lidhjes së njësisë helmetë të mos ju pengojë, përdorni mbajtësen e dhënë të kordonit të lidhjes dhe vendosni kordonin e lidhjes te shiriti i ulët i kokës.



Për një vendosje komode


Peshën e njësisë helmetë duhet ta ekuilibroni mes ballit dhe pjesës së pasme të kokës



Vendoseni njësinë helmetë në mënyrë të tillë që të ndihet e ekuilibruar mes mbështetëses së ballit dhe shiritit të ulët të kokës dhe më pas ripozicionojeni për ta sjellë lenten përpara syve, sigurohuni që të qëndrojnë mirë.

Sigurohuni që të lini hapësirë mes urës së njësisë helmetë (mes lenteve) dhe fytyrës suaj, në mënyrë që njësia të mos ju prekë hundën.

Sigurohuni që të puthitet mirë




Nëse një nga shiritat e kokës është tepër i lirë ose i shtrënguar, rregulloni gjatësinë e shiritit për puthitje më të mirë.

Për ta liruar, mbajeni poshtë butonin e shtrëngimit ndërsa tërhiqni fundin e djathtë të shiritit vetëm pak.

Për ta shtrënguar, shtypni pak fundin e djathtë të shiritit.

Shënim

- Kur lironi shiritat, sigurohuni që të arrini të shikoni vijat udhëzuese në shiritat. Nëse nuk arrini të shihni më një vijë udhëzuese, shirit mund të dalë nga shtrënguesja.




Vendosja dhe zëvendësimi i aurikularëve

Basi mund të mos dëgjohet në rast se nuk i vendosni mirë aurikularët. Për një përvojë më të mirë në dëgjim, provoni një masë tjetër aurikularësh ose rregulloni pozicionin e aurikularëve, në mënyrë që të puthiten në mënyrë të përkryer në veshë.

Aurikularët mesatarë kanë qenë të lidhur me kufjet që në fillim, në kohën e blerjes. Nëse kufjet nuk janë komode, provoni t'i zëvendësoni ato me aurikularë më të mëdhenj ose më të vegjël. Përmasat e aurikularëve janë me ngjyra me kode dhe mund të identifikohen sipas ngjyrës brenda. Për të shmangur rënien e aurikularëve nga veshi, sigurohuni t'i vendosni aurikularët mirë te kufjet kur i zëvendësoni ato.

Masat e aurikularëve (ngjyra e brendshme)



E vogël



E madhe

S (Portokalli)	M (E gjelbër)	L (Blu e lehtë)
-------------------	------------------	--------------------

Për të shkëputur një aurikular

Ndërsa mbani mirë me dorë kufjen, rrotulloni aurikularin ndërsa e tërhiqni.




Këshillë

- Nëse aurikulari ju rrëshqet në gishta dhe mbetet në kufje, provoni ta mbani me një pëlhurë të thatë për shtrëngim më të mirë.

Për të vendosur një aurikular

Rrotullojeni aurikularin ndërsa shtyni pjesën e ngjyrosur mbi bazën e kufjes, derisa baza të jetë mbuluar plotësisht.



Zëvendësimi i pjesëve të konsumit

Disponohen pjesët e mëposhtme të zëvendësueshme.

- Aurikularët*
- Mbulesa e mbështetëses së ballit
- Blllokuesi i dritës (lart) (1 secila majtas dhe djathtas)
- Blllokuesi i dritës (poshtë)
- Mbajtësja e kordonit të lidhjes


Kur këto pjesë konsumi prishen ose tregojnë shenja konsumimi, konsultohuni me shitësin ose qendrën më të afërt të servisit Sony.

* Blini aurikularë të vegjël, të mesëm ose të mëdhenj sipas nevojës.

Konfirmimi i drejtvendosjes së ekraneve

Konfirmoni drejtvendosjen e ekraneve duke iu referuar ekranit të konfirmimit të shfaqur në fillim pas rregullimit të hapësirës së lenteve. Ekranet në njësinë helmet përshkruhen më poshtë me një përshkrim se si të konfirmoni drejtvendosjen.




Seksioni i shikimit i njësisë helmetë përbëhet nga dy ekrane të vogla, në të majtë dhe në të djathtë. Imazhet në secilin ekran vendosen sipër njëra-tjetrës për të krijuar një imazh të vetëm. Gjithmonë kontrolloni drejtvendosjen e ekraneve duke iu referuar ekranit të konfirmimit përpara përdorimit për t'u siguruar që ekranet të drejtvendosen siç duhet.



Paraqitja e saktë

Për paraqitje të saktë të figurës, rrëshqitni rregulluesit e hapësirës së lenteve sipas nevojës në mënyrë që të tre shenjat "I" dhe vija horizontale të kryqëzohen.

Është e pranueshme nëse shenjat "I" dhe vija horizontale kryqëzohen në një pozicion tjetër nga qendra e ekranit.




Paraqitja e pasaktë


Nëse qoftë edhe një nga shenjat "I" dhe vija horizontale nuk kryqëzohen, njësia helmetë mund të shtrembëruar ose mund të jetë dëmtuar. Nëse ndodh kjo gjë, kontaktoni shitësin më të afërt Sony ose një qendër lokale të autorizuar Sony.



Shenjat "I" dhe vija horizontale nuk kryqëzohen.




Vija horizontale duket shumë e pjerrët.



Shenja e mesit "I" nuk kryqëzohet me vijën horizontale.

System Settings

Menytë e cilësimeve mund të aksesohen në çdo kohë për të ndryshuar ose rregulluar një shumëllojshmëri cilësimesh të sistemit, siç janë cilësia e figurës video, formati i daljes audio dhe formati i ekranit 3D. Për të parë menytë, shtypni butonin MENU në njësinë helmetë.



Funksionet e menysë bazë

- 1 Shtypni butonin MENU në njësinë helmetë.
- 2 Shtypni butonin ▲/▼ për të zgjedhur ikonën e kategorisë së dëshiruar të cilësimeve dhe më pas shtypni butonin MENU.
- 3 Shtypni butonin ▲/▼ për të zgjedhur menynë e dëshiruar dhe më pas shtypni butonin MENU.
- 4 Shtypni butonat ▲/▼/◀/▶ për të ndryshuar ose rregulluar cilësimet sipas nevojës dhe më pas shtypni butonin MENU për të futur ndryshimet.

- A Ikonat e kategorisë së cilësimeve
- B Kategoria
- C Menyja e cilësimeve
- D Cilësimet aktuale në secilën meny
- E Përmbledhja e menysë së përzgjedhur

Shënim

- Menyja e cilësimeve do të mbyllet automatikisht pas 90 sekondash mungese aktiviteti.

Këshilla

- Për t'u kthyer në menynë e mëparshme shtypni butonin ◀.
- Për të dalë nga menyja e cilësimeve, shtypni butonin ▶ në menynë e ikonës së kategorisë së cilësimeve.

Menytë

Cilësimet e parazgjedhura nënvizohen.

Informacioni

Identifikon sinjalet hyrëse (sinjalet video dhe audio) nga pajisja e lidhur me njësinë e përpunimit. "Unsupported signal" tregon se sinjali hyrës është i papërputhshëm me sistemin dhe tregohet "No signal" kur nuk del sinjal.

Lens span adjustment

Back	Kthehet në menynë e mëparshme.
Lens span adjustment	Rregullon hapësirën e lenteve të njësisë helmetë për t'iu përshtatur distancës mes syve (distanca mes bebeve të syve) për një përvojë optimale shikimi. Përdorni rregulluesit e hapësirës së lenteve në njësinë helmetë për rregullim. Për detaje, referojuni "Udhëzuesi i fillimit". Shënime • Pa hapësirën e rregulluar saktë të lenteve, nuk mund të shijoni një përvojë optimale shikimi. Gjithmonë rregulloni hapësirën e lenteve përpara përdorimit. • Audio vendoset në heshtje gjatë rregullimit. • Volumi nuk mund të ndryshohet gjatë rregullimit.


3D Settings

Back	Kthehet në menynë e mëparshme.
Reset	Rivendos të gjithë artikujt "3D Settings" në vlerat e tyre origjinale.

3D Display


Zgjidhni manualisht formatin e pamjes për përmbajtjen 3D. Cilësimet e disponueshme mund të variojnë nëse sinjali i burimit përfshin një sinjal identifikues të formatit 3D, si më poshtë.

Shembull i pamjes 3D




Për përmbajtjen 3D pa sinjal identifikues të formatit 3D

Side-by-Side: Zgjidhni për përmbajtje 3D nga cepi në cep, me imazhe të ngjashme që shfaqen nga cepi në cep.



Off: Zgjidhni të shfaqni përmbajtjen në format 2D.

Over-Under: Zgjidhni për përmbajtje 3D nga lart poshtë, me imazhe të ngjashme që shfaqen nga lart poshtë.



Për përmbajtjen 3D me sinjal identifikues të formatit 3D

On: Zgjidhni të shfaqni përmbajtjen në format 3D.

Off: Zgjidhni të shfaqni përmbajtjen në format 2D.

Shënime

- Nëse përmbajtja 3D nuk shfaqet saktë duke përdorur cilësimet e zgjedhura, provoni të ndryshoni "Side-by-Side" në "Over-Under" ose anasjelltas.
- Kur zgjidhni "Side-by-Side" ose "Over-Under" ndryshoni cilësimin në "Off" pas shikimit të përmbajtjes 3D.

Auto 3D	On: Kalon automatikisht në modalitetin e pamjes 3D kur diktohet një sinjali identifikimi i formatit 3D. Nëse sinjali identifikues i formatit 3D nuk diktohet më, sistemi kalon automatikisht në modalitetin e pamjes 2D. Off: Çaktivizon funksionin. Shënim Nëse imazhet nuk shfaqen në 3D kur "Auto 3D" është i vendosur në "On", provoni të ndryshoni cilësimin e "3D Display".
3D Signal Notification	On: Ju njofton kur diktohet një sinjali identifikimi i formatit 3D. Off: Çaktivizon funksionin.

Display

Back	Kthehet në menynë e mëparshme.
Picture Mode Detajet e opsionit "Picture Mode" që zgjidhni këtu mund të rregullohen te cilësimet nga "Reset" deri "Contrast Remaster" më poshtë.	Vivid: Ngjyra të gjalla dhe kontrast i fortë, për koncerte, sport dhe përmbajtje tjetër të transmetuar në televizion. Standard: Vë në pah një figurë natyrale. Cilësi e figurës standard për një shumëllojshmëri burimesh video. Cinema: Cilësi e figurës e krijuar posaçërisht për përmbajtje kinematografike. Game: Cilësi e figurës e krijuar posaçërisht për lojëra. Custom: Ruan cilësinë e figurës suaj të preferuar të personalizuar, duke rregulluar nga figura standarde origjinale.
Reset	Rivendos të gjitha vlerat (përveç vlerave të "24p True Cinema", "Wide Mode" dhe "Overscan" në "Display") të modalitetit të përzgjedhur në menynë "Picture Mode" në cilësimet e parazgjedhur kur përzgjidhni "Yes".
Picture	Rregullon kontrastin e imazhit.
Brightness	Përshtat ndriçimin e imazhit.
Color Temperature	Rregullon temperaturën e ngjyrës së imazhit. Natural: Optimizon automatikisht temperaturën e ngjyrës për secilën "Picture Mode", bazuar në karakteristikat e shikimit të njeriut. Cool: Tone ngjyrash në blu të freskët. Medium: Tone ngjyrash mes "Cool" dhe "Warm 1/Warm 2". Warm 1/Warm 2: Tone ngjyrash në të kuqe të ngrohtë. "Warm 2" është më e kuqe se "Warm 1".
Sharpness	Përforcon skajet e imazheve për t'i bërë imazhet të dallohen, ose zbut skajet për një efekt më të butë.

Frame Noise Reduction Nuk është e disponueshme me formatin e paketimit të kornizës 1080/24p.	Redukton "mizat" e figurës, të ngjashme me ndërprerjen. High/Medium/Low: Zgjidhni nivelin e këtij efekti. Off: Çaktivizon funksionin.
Block Noise Reduction Nuk është e disponueshme me formatin e paketimit të kornizës 1080/24p.	Redukton "mizat" e blloqeve në formë mozaiku në figurë. High/Medium/Low: Zgjidhni nivelin e këtij efekti. Off: Çaktivizon funksionin.
Mosquito Noise Reduction Nuk është e disponueshme me formatin e paketimit të kornizës 1080/24p.	Redukton "mizat" e lehta rreth skajeve të figurës. High/Medium/Low: Zgjidhni nivelin e këtij efekti. Off: Çaktivizon funksionin.
Panel Drive Mode	Zgjidhni llojin e metodës së shfaqjes për lëvizjen e figurës. Normal: Shfaqja e figurës standarde. Clear: Redukton turbullirën e imazheve që lëvizin shpejt. Shënime • Megjithëse përzgjedhja e "Clear" redukton turbullirën e imazheve që lëvizin shpejt, ajo errëson gjithashtu ekranin në tërësi. Nëse kjo është shpërqendruese, përzgjidhni "Normal". • Ekrani në tërësi mund të duket sikur dridhet, në varësi të sinjalit të burimit. Nëse kjo është shpërqendruese, përzgjidhni "Normal".
Cinema Conversion E disponueshme vetëm kur "Picture Mode" vendoset në "Cinema" ose "Custom". Nuk është e disponueshme me formatin e paketimit të kornizës 1080/24p.	Auto: Sistemi dikton automatikisht nëse po shikoni përmbajtje video (si për shembull telenovela dhe animacione) ose filma dhe kalon në metodën korresponduese të konvertimit. Video: Sistemi shfaq gjithmonë në një format për përmbajtje video, qoftë kur luan përmbajtje video ose film.
Clear Black	Rregulloni paraqitjen e fushave me figurë të errët. Riprodhimi bukur i ngjyrës së zezë, pa humbur nuancat e përgjithshme.
Contrast Remaster	Optimizon automatikisht nivelet e të zezës dhe të bardhës, për kontrast të mirë pa të zezë ose të bardhë të zbehur. High/Medium/Low: Zgjidhni nivelin e këtij efekti. Off: Çaktivizon funksionin.

24p True Cinema	On: Shfaq video 24 fps me besnikëri në 24 fps. Përbajtje kinematografike të këtij lloje është e disponueshme në Blu-ray Disc. Ofron përvojë të ngjashme me atë në kinema. Off: Çaktivizon funksionin. Sinjalet video 24 fps shfaqen pas konvertimit në 60 fps. Shënim Aktivizimi i këtij funksioni kur "Panel Drive Mode" vendoset në "Clear" mund ta bëjë ekranin të dridhet (në varësi të sinjalit të burimit), gjë që mund të jetë shpërqendruese. Në këtë rast, çaktivizoni këtë funksion ose vendoseni "Panel Drive Mode" në "Normal".
Wide Mode Nuk është e disponueshme gjatë riprodhimit 3D.	Normal: Shfaq imazhet në raportin origjinal të pamjes 4:3. Full: Shfaq përbajtjen 4:3 në ekran të plotë, duke i tërhequr imazhet horizontalisht. Edhe përbajtja 16:9 shfaqet në ekran të plotë, në raportin origjinal të pamjes. Zoom: I zmadhon imazhet vertikalisht dhe horizontalisht, duke ruajtur raportin origjinal të pamjes. Shënim "Normal" nuk është e disponueshme me burimet e hyrjes HD (1080i, 720p ose 1080p).
Overscan Nuk është e disponueshme gjatë riprodhimit 3D.	Rregullon zonën e shfaqjes. Auto: Rregullon automatikisht figurën në zonën optimale të shfaqjes. On: Fsheh skajet e figurës. Zgjidheni në rast problemesh të tilla si miza në skajet e figurës. Off: Shfaq të gjithë figurën.

 Sound

Back	Kthehet në menyne e mëparshme.
Reset	Rivendos të gjitha cilësimet "Sound" në vlerat e tyre origjinale.
Surround	Standard: Cilësim standard akustik, ofron projektim tingulli të bollshëm për gamën e përmbajtjes. Cinema: Vë në pah një projektim tingulli që rivalizon akustikën impresionuese të kinemave, veçanërisht për dialogët. Tërheqëse, me ndërthurje natyrale të secilit kanal. Zgjedhje e mirë për filmat. Game: Ideale për lojërat. Ofron lokalizim zëri të detajuar për një sens të qartë se nga del zëri. Për lojë tërheqëse në lojërat me efekte rrethuese me shumë kanale. E përshtatshme në veçanti për lojërat që kanë kolonë zanore me shumë kanale. Music: Vë në pah detajet dhe pastërtinë e audios burimore. Riprodhim besnik, i ngjashëm me pajisjet e monitorëve në studiot e regjistrimit. Zgjedhje e mirë për muzikën. Off: Çaktivizon efektet e zërit rrethues. Shënim • Volumi mund të variojë në varësi të sinjalit të audios burimore dhe modalitetit të zgjedhur të zërit rrethues.
Treble	Rregullon daljen e audios në frekuencë të lartë.
Bass	Rregullon daljen e audios në frekuencë të ulët.
Harmonics Equalizer Nuk është e disponueshme me sinjalet burimore përveç audio Dolby Digital dhe AAC.	On: Korrigjon formën e pjesës së pasme të valëve që fshihet nga algoritmet e ngjeshjes audio për shkak të amplitudës së ulët. Off: Çaktivizon funksionin.
A/V SYNC	Korrigjon sinjalet e pasinkronizuara mirë audio dhe video duke vonuar daljen audio. Dalja audio mund të vonohet me shkallëzime 10 milisekonda në një gamë prej 0-100 ms. Shënim • Një pjesë e audiove dhe videove të pasinkronizuara nuk mund të korrigjohen me këtë funksion, në varësi të sinjalit burimor.

Type of Headphones	Kalon në cilësimin optimal virtual të zërit rrethues për llojin e kufjeve të përdorura. Inner Ear: Ideale për pajisjet audio që vendosen në veshë, si p.sh. kufjet e dhëna. Overhead: Ideale për pajisjet audio që vendosen mbi ose në veshë. Shënim Efektet rrethuese të zërit mund të mos prodhohen saktë përveçse kur ky cilësim përputhet me llojin e kufjeve të përdorura.
Dual Mono Nuk është e disponueshme me sinjalet burimore përveç audio dual mono Dolby Digital dhe AAC.	Ndërron sinjalet burimore audio mono dual Dolby Digital ose AAC në dalje kryesore audio ose nën audio. Main: Daljet e të dyja kufjeve, majtas dhe djathtas, përbëhen vetëm nga përbërje kryesore audio. Sub: Daljet e të dyja kufjeve, majtas dhe djathtas, përbëhen vetëm nga përbërje nën audio. Main/Sub: Dalja e kufjeve në njërën anë përbëhet nga përbërje kryesore audio. Dalja në anën tjetër përbëhet nga përbërje nën audio.

General Setup

Back	Kthehet në menynë e mëparshme.
Set password Emri i këtij cilësimi ndryshon në "Cancel password" pasi futet fjalëkalimi.	Për të kufizuar përdorimin e sistemit mund të vendoset një fjalëkalim. Pasi të specifikohet një fjalëkalim, ai duhet të vendoset sa herë që sistemi është i aktivizuar. Për të anuluar mbrojtjen me fjalëkalim, zgjidhni "Cancel password" dhe vendosni fjalëkalimin. Shënim - Sistemi fiket automatikisht në situatat e mëposhtme. Ndizeni sistemin dhe vendosni sërish fjalëkalimin ose anuloni mbrojtjen me fjalëkalim. - Kur fjalëkalimi vendoset gabim dhe mbyllni menynë e afishuar të cilësimeve duke përdorur butonin MENU ose ◀ - Pas 90 sekondash mungese aktiviteti në ekranin e futjes së fjalëkalimit
LPCM Multi-Ch. Mode	On: Aktivizon marrjen në sinjale burimore me shumë kanale LPCM nga njësia e përpunimit. Off: Çaktivizon funksionin.
HDMI pass-through	On: Aktivizon pasazhin, duke ju mundësuar të shikoni ose dëgjoni përmbajtjen e një televizori ose një pajisjeje tjetër me ekran kur sistemi është në modalitet gatishmërie. Për detaje, referojuni "Udhëzuesi i fillimit". Off: Çaktivizon funksionin. Për të kursyer energji, zgjidhni "Off" me njësinë e përpunimit nuk është lidhur një televizor ose një pajisje tjetër me ekran.

Control for HDMI	On: Aktivizon kontrollin për pajisjet e përputhshme me HDMI CEC (Consumer Electronic Control) të lidhura me njësinë e përpunimit duke përdorur butonat ▲/▼/◀/▶ në njësinë helmetë. Butoni ▲: Fillon riprodhimin. Butoni ▼: Vendos në pauzë riprodhimin. Butoni ▲: Kërcen në kapitullin e mëparshëm. Mbani shtypur butonin për përshpejtim prapa. Butoni ▶: Kërcen në kapitullin tjetër. Mbani shtypur butonin për përshpejtim para. Off: Çaktivizon funksionin. Përdorni telekomandën e pajisjes së lidhur për ta kontrolluar atë. Shënim Nëse kontrolli nuk është i mundshëm me këtë cilësim të aktivizuar, pajisja e lidhur nuk është e përputhshme me funksionin "Control for HDMI" të sistemit. Kontrolloni pajisjen e lidhur në mënyrë direkte.
Power off when unmounted	On: Fik automatikisht sistemin 30 minuta pasi keni hequr njësinë helmetë. Off: Çaktivizon funksionin. Këshillë Pavarësisht nga ky cilësim, ekrani do të fiket automatikisht 10 sekonda pasi hiqni njësinë helmetë.
Illumination	On: Aktivizon ndriçimin në njësinë helmetë. Off: Çaktivizon funksionin.
Language setting	Vendos gjuhën e përdorur për meny të dhe elementë të tjerë të ndërfaqes. Shënime - Audio vendoset në heshtje gjatë kohës që konfigurohet ky cilësim. - Volumi nuk mund të rregullohet gjatë kohës që konfigurohet ky cilësim.
Prolonged viewing warning	On: Çaktivizon automatikisht ekranin e paralajmërimit për fikje pas 3 orësh shikimi të vazhdueshëm. Përzgjedhja e "Yes" në ekranin e paralajmërimit do të fikë energjinë. Përzgjedhja e "No" do të bëjë që energjia të fiket 3 orë më vonë, pas 6 orësh shikimi të vazhdueshëm. Off: Çaktivizon funksionin. Shënime - Kur paralajmërimi shfaqet pas 3 orësh shikimi, nëse nuk ka reagim brenda 90 sekondave, energjia do të fiket automatikisht. - Do të shfaqet një ekran paralajmërimi 30 minuta dhe 5 minuta përpara se sistemi të fiket vetë.

Startup viewer warning	On: Aktivizon shfaqjen automatike të një paralajmërimi ndezjeje. Off: Çaktivizon funksionin.
Reset to factory settings	Rivendos të gjitha cilësimet në vlerat e tyre origjinale. Shënim Do të fshihet edhe fjalëkalimi i vendosur në "Set password" (në "General Setup").

? Guide of HDMI device control

Shfaq udhëzuesin e përdorimit për butonat e njësisë helmetë që mund të përdoren me funksionin "Control for HDMI" (faqe 26).

Zgjidhja e problemeve

Nëse ndodhin shenjat e mëposhtme gjatë përdorimit të sistemit, kontrolloni kolonën Shkaku/Veprimi përpara se të kërkon shërbim. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni shitësin Sony ose një qendër lokale të autorizuar Sony.

Furnizimi me energji

Shenja	Shkaku/Veprimi
Sistemi nuk ndizet	→ Konfirmoni që kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) të futur plotësisht në prizë. → Sigurohuni që kordoni i lidhjes së njësisë helmetë të jetë futur plotësisht në folenë HMD OUT. → Ndezja normalisht kërkon disa sekonda.
Sistemi nuk fiket	→ Mbani shtypur butonin  (ndezur/në gatishmëri) për të paktën një sekondë.

Video

Shenja	Shkaku/Veprimi
Nuk ka video, ose dalja e videos është e distortuar	→ Referojuni "Udhëzuesi i fillimit" dhe konfirmoni që kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjeti elektrik), kabllloja HDMI dhe kordoni e lidhjes së njësisë helmetë të jenë të lidhura saktë. → Sigurohuni që pajisja e lidhur me folenë HDMI IN në njësinë e përpunimit të jetë e ndezur. → Konfirmoni që sinjali burimor mbështetet nga sistemi. Për informacion mbi sinjalet e mbështetura, shikoni "Sinjalet e mbështetura për hyrjet dhe daljet HDMI:" në "Specifikimet" (faqe 35). → Kur me këtë sistem përdoret PlayStation®3 (PS3™) dhe nëse cilësimet e daljes video dhe audio në PS3™ nuk përputhen me ato në këtë sistem ose kabllon dhe televizorin në përdorim, mund të mos ketë dalje video dhe audio. Nëse ndodhin këto shenja, fikni PS3™ dhe më pas ndizeni sërish duke shtypur butonin e energjisë për të paktën 5 sekonda derisa të dëgjoni dy herë një tingull bip. Cilësimet e daljes video dhe audio do të rivendosen automatikisht në cilësimet standarde. → Nëse nuk ka dalje video kur ky sistem përdoret me pajisje riprodhuese ndryshe nga PlayStation®3 (PS3™), ndaloni riprodhimin për një moment dhe rifillojeni sërish. Nëse problemi vazhdon, provoni të rindizni pajisjen e riprodhimit. → Kabllloja HDMI mund të jetë tepër e lirë. Konfirmoni që kabllloja HDMI të jetë futur plotësisht në prizë. Nëse nuk përmirësohet cilësia video, kabllloja HDMI mund të jetë e dëmtuar. Në këtë rast, provoni një kablo të re. → Kur zgjidhni "Side-by-Side" ose "Over-Under" në "3D Display" (në "3D Settings"), ndryshoni cilësimin në "Off" pas shikimit të përmbajtjes 3D (faqe 20). → Nëse pajisja është e lidhur një njësi përpunimi nëpërmjet një amplifikatori AV (marrësi), provoni ta lidhni pajisjen direkt me njësinë e përpunimit. Për detaje, referojuni manualit të udhëzimeve të pajisjes së përdorur. → Kur përdorni një selektor HDMI, sigurohuni që hyrja në selektor të jetë zgjedhur saktë. → Përdorni ose kabllon e dhënë HDMI ose një kablo HDMI që mund të blihet në dyqan, të identifikuar si kablo e shpejtësisë së lartë. → Sigurohuni që të çaktivizoni daljen video me sinjalin e ngjyrës së thellë në pajisjen e lidhur. Nëse ky opsion nuk është i disponueshëm në pajisje dhe përmbajtja del në 1080/60p, ndryshoni modalitetin e daljes video të HDMI në modalitetin 1080i.

Shenja	Shkaku/Veprimi
Ekrani është i errët ose i turbullt	→ Referojuni "Udhëzuesi i fillimit" dhe konfirmoni që kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjeti elektrik), kablloja HDMI dhe kordoni e lidhjes së njësisë helmetë të jenë të lidhura saktë dhe që e keni vendosur njësinë helmetë saktë. → Hapësira mes lenteve është vendosur në mënyrë të pasaktë (faqe 17). Kryeni sërish rregullimin duke aksesuar "Lens span adjustment" në menynë e cilësimeve (faqe 19). → Nëse lentet në njësinë helmetë janë ndotur, fshijini ato me një copë të butë të thatë për t'i pastruar.
Ekranet fiken papritur	→ Pas 3 orësh shikimi të vazhdueshëm, sistemi do të shfaqë një ekran paralajmërimi dhe do të fiket pas 90 sekondash mungese aktiviteti. Nëse e largoni mesazhin dhe vazhdoni shikimin, sistemi do të fiket automatikisht pas 3 orësh të tjera për të inkurajuar krijimin e zakoneve të shëndetshme në shikim. Për detaje, shihni "Prolonged viewing warning" (faqe 26). → Vendoseni njësinë helmetë siç duhet. 10 sekonda pasi sensori në njësinë helmetë të diktojë se e keni hequr njësinë, ekrani i shfaqur do të fiket automatikisht. Për detaje, shihni "Power off when unmounted" (faqe 26).
Shfaqja e figurës errësohet me kalimin e kohës	→ Megjithëse shfaqja e fotove ose imazheve pothuajse të palëvizshme mund të errësohet me kalimin e kohës, kjo nuk tregon se sistemi është i dëmtuar. Për të rikthyer ndriçimin normal, kryeni ndonjë veprim me njësinë helmetë ose direkt në pajisjen e lidhur.
Disa piksel në ekran nuk ndizen, ose disa janë gjithmonë të ndezura	→ Megjithëse panelet OLED janë prodhuar duke përdorur teknologji prodhimi me precision jashtëzakonisht të lartë, në disa raste pikselat mund të qëndrojnë në mënyrë të përhershme të zeza, ose mund të kenë ngjyrë të kuqe, blu ose të gjelbër. Kjo nuk tregon se sistemi është i dëmtuar.
Disa skena në një disk Blu-ray të regjistruara në 24 fps (sipas filmit original) nuk duken të natyrshme	→ Në këtë rast, provoni të aktivizoni "24p True Cinema". Për detaje, shihni "24p True Cinema" (faqe 23).
Ekrani dridhet	→ Disa sinjale burimore mund të shkaktojnë që ekranin të dridhet i tëri kur "Panel Drive Mode" është vendosur në "Clear", ose kur aktivizohet "24p True Cinema". Për detaje, shihni "Panel Drive Mode" (faqe 22) dhe "24p True Cinema" (faqe 23).

Shenja	Shkaku/Veprimi
Videoja nuk tregohet në 3D	→ Nëse e njëjta figurë shfaqet nga cepi në cep, ose lart dhe poshtë, mund të mos jetë i saktë cilësimi i formatit të shfaqjes 3D. Provoni të ndryshoni cilësimin "3D Display" në "3D Settings" (faqe 20). → Perceptimi i 3D varion sipas shikuesit. → Nëse shfaqet menyja "3D Settings" por imazhet nuk shfaqen në 3D, provoni të rindizni pajisjen e lidhur të përdorur për riprodhimin 3D. → Sistemi nuk mbështet konvertimin 2D në 3D (3D e stimuluar). → Shikimi i imazheve anaglife në 3D kërkon syze anaglife (me lente të kuqe dhe blu për shembull). → Gjithashtu, kontrolloni cilësimet e pajisjes së riprodhimit të lidhur me folenë njësinë e përpunimit. → Kur me këtë sistem përdoret PlayStation®3 (PS3™) dhe nëse cilësimet e daljes video dhe audio në PS3™ nuk përpunohen me ato në këtë sistem ose kabllon dhe televizorin në përdorim, mund të mos ketë dalje video 3D. Nëse ndodhin këto shenja, fikni PS3™ dhe më pas ndizeni sërish duke shtypur butonin e energjisë për të paktën 5 sekonda derisa të dëgjoni dy herë një tingull bip. Cilësimet e daljes video dhe audio do të rivendosen automatikisht në cilësimet standarde. → Nëse nuk ka dalje video 3D kur ky sistem përdoret me pajisje riprodhuese ndryshe nga PlayStation®3 (PS3™), ndaloni riprodhimin për një moment dhe rifillojeni sërish. Nëse problemi vazhdon, provoni të rindizni pajisjen e riprodhimit.
Pamja 3D nuk aktivizohet automatikisht	→ Sigurohuni që cilësimi "Auto 3D" në "3D Settings" të jetë vendosur në "On" (faqe 21). → Përmbajtja 3D pa sinjal identifikimi të formatit 3D nuk shfaqet automatikisht në 3D. Provoni të ndryshoni cilësimin "3D Display" në "3D Settings" në "Side-by-Side" ose "Over-Under" (faqe 20).

Audio

Shenja	Shkakuj/Veprimi
Nuk ka zë / Ka ndërprerje / Volumi nuk mund të shtohet	→ Fisha e kufjeve nuk është lidhur mirë. Nëse kufjet nuk janë lidhur mirë, zëri që del prej tyre do të jetë i dobët. Futni fishën e kufjeve derisa të futen në vend me një kërcitje (faqe 10). → Fisha e kufjeve nuk është e pastër. Pastroni fishën e kufjeve me një pëlthurë të butë të thatë. → Rregulloni volumin duke përdorur butonat VOL +/–. → Referojuni "Udhëzuesi i fillimit" dhe konfirmoni që kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjeti elektrik), kabloja HDMI dhe kordoni e lidhjes së njësisë helmetë të jenë të lidhura saktë. → Konfirmoni që sinjali burimor mbështetet nga sistemi. Për informacion mbi sinjalet e mbështetura, shikoni "Sinjalet e mbështetura për hyrjet dhe daljet HDMI:" në "Specifikimet" (faqe 35). Nëse sinjali i hyrjes është i pambështetur, kontrolloni cilësimet e daljes audio të pajisjes së lidhur. → Kur me këtë sistem përdoret PlayStation®3 (PS3™) dhe nëse cilësimet e daljes video dhe audio në PS3™ nuk përputhen me ato në këtë sistem ose kabllon dhe televizorin në përdorim, mund të mos ketë dalje video dhe audio. Nëse ndodhin këto shenja, fikni PS3™ dhe më pas ndizeni sërish duke shtypur butonin e energjisë për të paktën 5 sekonda derisa të dëgjoni dy herë një tingull bip. Cilësimet e daljes video dhe audio do të rivendosen automatikisht në cilësimet standarde. → Nëse nuk ka dalje video kur ky sistem përdoret me pajisje riprodhuese ndryshe nga PlayStation®3 (PS3™), ndaloni riprodhimin për një moment dhe rifillojeni sërish. Nëse problemi vazhdon, provoni të rindizni pajisjen e riprodhimit. → Nëse pajisja është e lidhur një njësi përpunimi nëpërmjet një amplifikatori AV (marrësi), provoni ta lidhni pajisjen direkt me njësinë e përpunimit. Për detaje, referojuni manualit të udhëzimeve të pajisjes së përdorur. → Kur sistemi është i lidhur me sisteme të kinemasë në shtëpi të përputhshme me HDMI CEC ose amplifikatorë AV (marrës), kontrolloni cilësimet e mëposhtme. – Sigurohuni që cilësimi "Control for HDMI" në "General Setup" të jetë vendosur në "On" (faqe 26). – Sigurohuni që "Control for HDMI" të jetë aktivizuar në amplifikatorin AV (marrësi) ose pajisje tjetër. Për detaje, referojuni manualit të udhëzimeve të pajisjes së përdorur. → Për hyrje me shumë kanale LPCM, sigurohuni që cilësimi "LPCM Multi-Ch. Mode" në "General Setup" të jetë vendosur në "On" (faqe 25).
Nuk ka efekt zanor rrethues	→ Sigurohuni që cilësimi "Surround" në "Sound" të mos jetë vendosur në "Off" (faqe 24). → Sigurohuni që cilësimi "Type of Headphones" në "Sound" të jetë i saktë për llojin e kufjeve të përdorura (faqe 25). → Perceptimi i tingullit varion sipas dëgjuesit.
Nuk ka bas	→ Sigurohuni që aurikularët të qëndrojnë rehat në veshë (faqe 15).

Shenja	Shkaku/Veprimi
Nuk ka hyrje audio në formatin Dolby Digital ose AAC	→ Pajisja e riprodhimit mund të jetë konfiguruar të konvertojë sinjalet e daljes audio Dolby Digital ose AAC në sinjale LPCM. Në këtë rast, në cilësimet e pajisjes së riprodhimit, çaktivizoni konvertimin Dolby Digital ose AAC dhe më pas rifilloni riprodhimin. Për detaje, referojuni manualit të udhëzimeve të pajisjes së përdorur.
Riprodhimi audio nuk është në formatin e duhur	→ Për audio dual mono, ndryshoni cilësimin "Dual Mono" në "Sound" (faqe 25). Për formate të tjera audio, kontrolloni cilësimet e pajisjes së lidhur.

Kontrolli i HDMI

Shenja	Shkaku/Veprimi
Pajisja e lidhur nuk mund të kontrollohet duke përdorur butonat në njësinë helmetë	→ Sigurohuni që pajisja e lidhur të mbështesë funksionet HDMI CEC. → Sigurohuni që cilësimi "Control for HDMI" i pajisjes së lidhur të jetë konfiguruar saktë. Për detaje, referojuni manualit të udhëzimeve të pajisjes së përdorur. → Amplifikatori i lidhur AV (marrësi) mund të mos jetë i përputhshëm me funksionin "Control for HDMI" të sistemit. Funksioni "Control for HDMI" nuk do të funksionojë saktë në këtë rast. → Kontrollimi i pajisjes së lidhur duke shtypur butonat në njësinë helmetë mund të mos jetë i mundshëm menjëherë pas ndezjes së sistemit, ose menjëherë pas aktivizimit të "Control for HDMI" në "General Setup". → Sigurohuni që cilësimi "Control for HDMI" në "General Setup" të jetë vendosur në "On" (faqe 26).

Probleme të tjera

Shenja	Shkaku/Veprimi
Treguesi i energjisë pulson në ngjyrë të kuqe	→ Nëse treguesi pulson dy herë çdo 3 sekonda, njësia helmetë ose njësia e përpunimit mund të jetë dëmtuar. Kontaktoni shitësin Sony ose qendrën lokale të autorizuar Sony. → Nëse treguesi pulson tre herë çdo 3 sekonda, njësia helmetë ose njësia e përpunimit është mbinxehur. Prisni derisa njësia të ftohet dhe pulsimi të ndalojë. Sigurohuni që të mos mbuloni ose bllokoni vrimat e ajrosjes së njësisë së përpunimit për ajrosjen e duhur. → Nëse treguesi pulson katër herë çdo 3 sekonda për një minutë, njësia helmetë është mbinxehur. Prisni derisa njësia të ftohet dhe pulsimi të ndalojë. → Nëse treguesi pulson pesë herë çdo 3 sekonda për një minutë, si njësia helmetë ashtu edhe njësia e përpunimit janë mbinxehur. Prisni derisa njësitë të ftohen dhe pulsimi të ndalojë.

Shenja	Shkaku/Veprimi
Kur sistemi është i fikur, videoja dhe audioja nga pajisja e riprodhimit nuk luhet në një televizor të lidhur me folenë HDMI OUT	→ Konfirmoni që kabllo HDMI të jenë lidhur plotësisht. → Vendosni "HDMI pass-through" në "General Setup" në "On" (faqe 25). → Kalojeni burimin e hyrjes në televizor në këtë sistem. → Kontrolloni cilësimet e daljes HDMI në pajisjen e riprodhimit.
"Control for HDMI" në televizor nuk mund të përdoret për të kontrolluar pajisjen e riprodhimit edhe kur përdoret pasazhi HDMI i sistemit	→ Referojuni manualit të përdorimit që keni marrë me televizorin, dhe në cilësimin "Control for HDMI" të televizorit, specifikoni pajisjen e riprodhimit të lidhur me njësinë e përpunimit si pajisje kontrolluese.
Butonat e njësisë helmetë nuk përgjigjen	→ Butonat në njësinë helmetë nuk funksionojnë nëse nuk e keni vendosur njësinë.
"DEMO" shfaqet në këndin e djathtë lart të ekranit të menysë së cilësimeve	→ Kontaktoni shitësin Sony ose qendrën lokale të autorizuar Sony.
Nuk mund të rregulloj "Language setting" sepse menyja e cilësimeve është në një gjuhë që nuk e njoh	→ Nëse nuk është përfunduar konfigurimi fillestar, shtypni vazhdimisht butonin ◀ për t'u kthyer te ekran i përzgjedhjes së gjuhës dhe më pas zgjidhni gjuhën tuaj të preferuar sërish. → Nëse e keni përfunduar konfigurimin fillestar, ndiqni këto hapa për të rikthyer sistemin në gjendjen origjinale të fabrikës dhe specifikoni gjuhën e duhur. 1 Shtypni butonin MENU për të shfaqur menytë e cilësimeve. 2 Shtypni butonin ▼ dhe zgjidhni  (ikonën "General Setup"). 3 Shtypni butonin ► dhe lëvizni kursorin në të djathtë. 4 Shtypni butonin ▼ lëvizni kursorin në cilësimin e fundit. 5 Shtypni butonin MENU. (Shfaqet një mesazh konfirmimi "Reset to factory settings"). 6 Shtypni butonin ◀ dhe më pas shtypni butonin MENU. (Sistemi do të rindizet). 7 Pasi të shfaqet ekran i konfigurimit fillestar, shtypni butonat ▲/▼ për të përzgjedhur gjuhën tuaj të preferuar dhe më pas shtypni butonin ►. 8 Ndiqni udhëzimet e shfaqura për të përfunduar konfigurimin fillestar.

Specifikimet

Kërkesat për energjinë

Modeli i Amerikës së Veriut:

120 V AC, 60 Hz

Modelet e Mbretërisë së Bashkuar,

Hong-Kongut, Lindjes së Mesme,

Afrikës së Jugut dhe Oqeanisë:

220 V – 240 V AC, 50/60 Hz

Modelet e Rusisë dhe Ukrainës:

220 V – 240 V AC, 50/60 Hz

Modeli i Tajvanit:

110 V AC, 60 Hz

Modeli i Kinës:

220 V – 240 V AC, 50/60 Hz

Modeli i Koresë së Jugut:

220 V AC, 60 Hz

Modeli i Indisë:

220 V – 240 V AC, 50/60 Hz

Modeli i Meksikës:

120 V AC, 50/60 Hz

Modelet e tjera:

110 V – 240 V AC, 50/60 Hz

Konsumi i energjisë

15 W (në përdorim)

0,25 W (në modalitet gatishmërie)

1,6 W (në modalitet gatishmërie duke përdorur pasazhin HDMI)

Temperatura ku mund të përdoret

5 °C deri 35 °C (41 °F deri 95 °F)

Lagështira ku mund të përdoret

25 % deri 80 %

Përmasat (Gj×L×Th, duke përfshirë zgjatimet më të mëdha)

Njësia helmetë:

Rreth 187 mm × 104 mm × 254 mm
(7 3/8 inç × 4 1/8 inç × 10 inç)

Njësia e përpunimit:

Rreth 180 mm × 36 mm × 168 mm
(7 1/8 inç × 1 7/16 inç × 6 5/8 inç)

Masa

Njësia helmetë:

Rreth 330 g (12 oz) (duke përjashtuar kordonin e lidhjes)

Njësia e përpunimit:

Rreth 600 g (22 oz) (duke përjashtuar kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik))

Rezolucioni i pamjes

1280 pika (horizontale) × 720 pika (vertikale)

Distanca mes bebeve të syve

55 mm – 72 mm (2 1/4 inç – 2 7/8 inç)

Hyrjet dhe daljet

HMD OUT:

Konektor i dedikuar me 15 kunj

HDMI IN dhe HDMI OUT*:

Konektor standard HDMI me 19 kunj

Sinjalet e mbështetura për hyrjet dhe daljet HDMI:

Hyrja video (formatet 2D):

480/60p, 576/50p, 720/24p, 720/50p, 720/60p, 1080/50i, 1080/60i, 1080/24p, 1080/50p, 1080/60p

Hyrja video (formatet 3D): formatet Frame Packing, Side-by-Side dhe Top-and-Bottom):

720/50p, 720/60p, 1080/50i, 1080/60i, 1080/24p

Hyrja audio:

Lineare PCM (2/me shumë kanale, 32/44,1/48 kHz), Dolby Digital (2/me shumë kanale, 32/44,1/48 kHz), AAC (2/me shumë kanale, 32/48 kHz)

Foleja e kufjeve:

Minifoleja stereo

* Kur pasazhi HDMI është i aktivizuar, sinjalet që furnizojnë njësinë e përpunimit kalojnë përmes njësisë së përpunimit drejt daljes HDMI. Megjithatë, sinjalet e mëposhtme nuk janë të përputhshme me pasazhin.

- Sinjalet e ngjyrës së thellë
- Sinjalet video me rezolucion 4k (në rezolucion të lartë që tejkalon 3840 (horizontale) × 2160 (vertikale) piksel)

Kufjet (të dhëna)

Reagimi i frekuencës:

5 Hz - 24 000 Hz

Rezistenca:

16 Ω (1 kHz)

Aksesorët shoqërues

Shihni "Aksesorët e dhënë" (faqe 8).

Specifikimet e sistemit dhe pamja u nënshtrohen ndryshimit për përmirësim pa dhënë njoftim.

Njoftim i licencës dhe markës tregtare

Markat tregtare

- Termat HDMI™ dhe HDMI High-Definition Multimedia Interface, dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të HDMI Licensing LLC në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.

HDMI

- Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby dhe simboli me dy "D" janë marka tregtare të Dolby Laboratories.
- "PlayStation" është markë tregtare e regjistruar e Sony Computer Entertainment Inc. Gjithashtu, edhe "PS3" është markë tregtare e të njëjtës kompani.
- VPT, Virtualphones Technology është markë tregtare e regjistruar e Sony Corporation.
- Emrat e sistemeve dhe produkteve të tjera janë në përgjithësi marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të prodhuesve. Markat ™ dhe ® nuk tregohen në këtë dokument.

Njoftimet dhe licencat për softuerët e përdorur në këtë produkt

Pjesë të softuerëve në këtë produkt janë të licencuar nën licencën e The FreeType Project.

Pjesë të këtij softueri kanë të drejta të autorit © 2006 The FreeType Project (www.freetype.org). Të gjitha të drejtat të rezervuara.

<http://www.sony.net/>

Printuar mbi letër të ricikluar
70% ose më shumë duke përdorur
bojë vaji me bazë vegjetale pa VOC
(përbërës organikë të ajrit).

© 2012 Sony Corporation



4-439-019-**11**(1) (AL)